



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.04.2018
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Mars 01.03.2018 – 31.03.2018

DKA edhe gjatë muajit Mars ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

Për nderë të festës së **7 Marsit Ditës së Mësuesit**, DKA ka organizuar takim me drejtorët dhe mësimmshënësit e shkollave në të cilin takim u ndanë mirënjohje për mësimmshënësit e dalluar në nivel shkolle. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2018. Të gjitha Shkollat e kanë shënuar këtë ditë me organizime festive.

Ka përfunduar vlerësimi i dosjeve të mësimmshënësve të trajnuar për kurrikulë, të cilët kanë punuar me parafillor, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë, dhe që kanë filluar zbatimin e kurrikulës nga viti shkollor **2017/2018**.

Është mbajtur takim i ekipit profesional për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta, me kërkesë të drejtorëve të shkollave është bërë vlerësimi i dy nxënësve.

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillimin e procedurave të prokurimit për:

- Renovimin shkollave në: Shfmu “7 Marsi” në Poturoc, Shfmu “Hasan Zyko Kamberi” në Sllavi dhe Shfmu “Ibrahim Krsniqi” në Smallushë.
- Furnizimin e disa shkollave me gjenerator,
- Pajisjen e shkollave me inventar
- Dezinfektimin dhe Derrtizimin e objektit të Çerdhës Çeap në Lipjan (DDD),
- Furnizimin e disa shkollave me kabinete-Kimi, Fizikë, Biologji dhe Informatikë,
- Furnizimin me dru për të gjitha shkollat për vitin shkollor **2018/2019**.

Kërkesë DPU-së për paramasë dhe paralogari -rregullimi i infrastrukturës në oborret e shkollave:

- Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan, p.n.f në Bregu i Zi
- Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure, p.n.f në Mirenë.

Kërkesë Komunës së Graçanicës-Marrja e obligimeve ligjore për menaxhimin e shkollës në fshatin Radevë nga Komuna e Graçanicës.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimim në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.